



Index out: YIHR-KS-12-4825-23-01-14

Të nderuar,

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë është organizatë joqeveritare për të drejtat e njeriut, e cila gjatë punës së saj, tashmë disa vjeçare, ka bërë monitorimin e përzgjedhjes së Avokatit të Popullit në vitin 2009 dhe monitorimin e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit në vitin 2013. Andaj, me qëllim të vazhdimit të monitorimit të përzgjedhjes së Avokatit të ri të Popullit, parashtrojmë këtë:

### **Kërkesë**

Që të na mundësoni qasje në aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën e Avokatit të Popullit, të shpallur nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Sipas shpalljes, afati për aplikim përfundon sot, më 23 janar 2014. Andaj, sipas **nenit 1** dhe **nenit 6** të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (**Nr. 03/ L-215**), ne kërkojmë kopjet e të gjitha aplikacioneve që kanë arritur në zyrën tuaj deri në përfundim të këtij afatit.

Shpresojmë që kërkesa jonë të shqyrtohet brenda afateve ligjore dhe të marrim përgjigje nga ju, duke kontribuar kështu në një proces sa më transparent të përzgjedhjes së Avokatit të Popullit.

Ju falënderojmë paraprakisht!

Me respekt,  
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut- Kosovë

Index out: YIHR-KS-12-4836-03-02-14

I nderuar z. Krasniqi,

Pas pranimit të përgjigjes tuaj negative në lidhje me kërkesën tonë Index out: YIHR-KS-12-4825-23-01-14, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë parashtron këtë:

### Plotësim kërkesë

Për qasje në aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën e Avokatit të Popullit, të shpallur nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parë e kemi lënë në diskrecionin tuaj që të vlerësoni se cilat të dhëna nga aplikacioni duhet të bëhen publike dhe cilat jo. Jemi të vetëdijshëm se nuk mund të lejohet qasja në dosjet complete të kandidatëve (CV, letër motivimi, dhe dokumentet e tjera që kandidatëve u kërkohen për dorëzim) për aplikim në postin e Avokatit të Popullit. Mirëpo, mund të lejohet qasja në informata të caktuara të cilat kanë qenë të kërkuara në konkursin publik, si p.sh: emri dhe mbiemri, përgatitja profesionale, përvoja e punës, aftësitë e tjera siç janë ato kompjuterike, njohja e gjuhëve të huaja etj.

Në përgjigjen tuaj thuhet se një dokumentacion i tillë ende nuk cilësohet si dokument publik dhe shpërndarja e tij do të ishte në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe se Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë, është ftuar nga Paneli Rekrutues për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit, për ta monitoruar procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit. Mirëpo, ne nuk mund të pajtohemi me këtë dhe arsyet janë si më poshtë:

1. Ne nuk pajtohemi me vlerësimin tuaj të cekur në përgjigjen tuaj se aplikacionet në fjalë nuk janë dokumente publik në këtë fazë të procesit. Me vetë faktin se aplikacioni është publikuar nga Kuvendi i Kosovës e bën atë dokument publik. Nismës të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë dhe qytetarëve nuk ju interesojnë të dhënat që përmban aplikacioni në pikat 1-11. Mirëpo, të dhënat nga pika 12 e aplikacionit dhe në vazhdim, është e rëndësishme të bëhen të ditura.
2. Në rast se Kuvendi i Kosovës ka dilema në klasifikim e një dokumentacioni të tillë si publik, atëherë ne kërkojmë që t'i drejtoheni Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për opinion.
3. Në përgjigjen tuaj ju keni përmendur faktin se Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë, është ftuar nga Paneli Rekrutues për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit, për ta monitoruar procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit, me ç'rast mund të njoftohet me të gjitha të dhënat dhe procedurat, konform dispozitave në fuqi. Ne e vlerësojmë këtë dhe gjithsesi do të jemi të pranishëm dhe do të monitorojmë me profesionalizëm tërë procesin, siç kemi bërë edhe herëve tjera. Megjithatë, kjo nuk paraqet realizim e lirisë tonë së shprehjes të garantuar me Kushtetutë, nenin 40 i cili ndër të tjera thotë: *“Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush”*. Prezenca jonë në cilësinë e monitoruesit të procesit nuk do të thotë domosdoshmërisht realizimin e të drejtës tonë për të marrë informacion dhe për të shpërndarë atë. Prandaj, të dhënat duhet të bëhen publike.

4. Po ashtu, ju rikujtojmë opinionin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i dhënë me kërkesë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cila e interpreton nenin 5 paragrafi 1, dhe nënparagrafi 1.5 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ([http://www.amdp-rks.org/web/repository/docs/Opinion\\_i\\_MKRS.pdf](http://www.amdp-rks.org/web/repository/docs/Opinion_i_MKRS.pdf)). Sipas nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "përpunimi është i nevojshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ...". Opinioni në fjalë i bën këtë interpretim këtij neni: *"mund të konkludohet se ekziston neni i ligjit, i cili thirret në përpunimin e të dhënave personale, kur është fjala për interesin publik. Me këtë mund të konkludohet se disa informata mbi kandidatët e cekur më lart mund të jepen, pikërisht për të respektuar nenin 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe mbrojmë parimisht përpunimin e tyre. Ne besojmë se këto të dhëna (emri, kualifikimet, përvojën e punës, aftësi të tjera të tilla si aftësitë kompjuterike, gjuhë të huaja, etj.) janë të mjaftueshme për të kënaqur interesat e publikut, dhe nuk janë të tepërta në arritjen qëllimit dhe nuk kompromitojnë dinjitetin e subjektit të të dhënave."* Të dhënat e kandidatëve për Avokatit e Popullit si p.sh: emri, përgatitja profesionale, përvoja e punës, aftësitë e tjera siç janë ato kompjuterike, njohja e gjuhëve të huaja etj. janë të domosdoshme për të kënaqur interesat e publikut në këtë rast.
5. Po ashtu, paraqesim edhe rastin praktik të Këshillit të Evropës si praktikë që duhej ndjekur (<http://assembly.coe.int/Documents/WorkingDocs/doc12/COE.PACE.WD.COM.12936.2012.EN.pdf>). Me rastin e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës ka bërë publike përmes ueb-faqes aplikacionet e kandidatëve të dominuar nga shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës, për pozitën e gjyqtarit në GJEDNJ. Kjo për hirë të transparencës dhe kënaqjes së interesit publik. Avokati i Popullit mbron interesat e qytetarëve, dhe është në interesin e qytetarëve të jenë të informuar për tërë procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit.
6. Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut- Kosovë, siç e kemi cekur edhe në kërkesën fillestare (Index out: YIHR-KS-12-4825-23-01-14), ka bërë monitorimin e përzgjedhjes së Avokatit të Popullit në vitin 2009 ku kemi pasur qasje edhe në aplikacionet e kandidatëve.

Së fundmi, kërkojmë që 26 aplikacionet e pranuar (pa marrë parasysh faktin se i plotësojnë apo jo kriteret e konkursit publik) të shpallen në ueb-faqen zyrtare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Nëse për çfarëdo arsye kjo nuk është e mundur, atëherë ne kërkojmë që të na dërgoni kopjet e të gjitha aplikacioneve që kanë arritur. Shpresojmë që kërkesa jonë të shqyrtohet brenda afateve ligjore dhe të marrim përgjigje nga ju, duke kontribuar kështu në një proces sa më transparent të procesit të përzgjedhjes së Avokatit të Popullit.

Bashkangjitur me këtë kërkesë janë :

- 1) Kërkesa fillestare drejtuar Parlamentit të Kosovës- Index out: YIHR-KS-12-4825-23-01-14,
- 2) Përgjigja e Parlamentit në kërkesën tonë,
- 3) Opinioni i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- 4) Ueb-sajtin e printuar të Këshillit të Evropës.

Ju falënderojmë paraprakisht!

Me respekt,  
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut- Kosovë